RREGULLORE E CERTIFIKIMIT TE SISTEMEVE TE MENAXHIMIT TE SIGURISE USHQIMORE

TITULLI I DOKUMENTIT	RREGULLORE E CERTIFIKIMIT TE SISTEMEVE TE MENAXHIMIT TE SIGURISE USHQIMORE
KODI	RR-C-006.
RISHIKIMI	03
DATA	25.03.2020

Hartimi	Kontrolli	Aprovimi

Kjo rregullore është e ndarë në 4 seksione në varësi të shërbimit të certifikimit të kërkuar: Seksioni 1:
Certifikimi i Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore sipas ISO 22000:2018
Seksioni 2:
Certifikimi i Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore sipas ISO 22000:2005
Seksini 3:
Kalimi i certifikimit nga ISO 22000:2005 në ISO 22000:2018
Seksioni 4:
Certifikimi i Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore sipas skemës së FSSC 22000 v.4.1

SEKSIONI 1: CERTIFIKIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË USHQIMORE NË KONFORMITET ME ISO 22000:2018
KAPITULLI 1 – TË PËRGJITHSHME.
1.1
Këto rregulla përcaktojnë procedurat shtesë ose zëvendësuese të zbatuara nga AQSCERT për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore në lidhje me cfarë është e përcaktuar në Rregullore e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit. Paragrafët e këtyre Rregullave i referohen paragrafëve korrespondues të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, në të cilat janë bërë ndryshime dhe/ose shtesa.

1.2
AQSCERT u lëshon certifikime sipas kërkesave të standartit ISO/IEC 17021:2015 kompanive, Sistemi i Menaxhimit të të cilave është pranuar që është konform të gjitha kërkesave të standartit ISO 22000:2018.

KAPITULLI 2 – STANDARTI REFERENCË / KËRKESAT E CERTIFIKIMIT
2.1
Përvec cfarë është deklaruar në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, për të marrë një certifikim AQSCERT një Sistem i Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore në fillim duhet të përmbush kërkesat e ISO 22000 dhe kërkesat shtesë, nëse ka, nga organizmat akreditues.

2.2
Si zëvendësim i cfarë është përcaktuar në paragrafin 1.2 të Rregullores së përgjithshme , në vecanti, për të arritur certifikimin e sistemit të menaxhimit, Kompania duhet të ketë përgatitur Dokumentacionin, i cili është:

- Përcaktimi i objektivave/qëllimit/fushës së aplikimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore, duke përshkruar proceset kryesore midis të cilave protokollet e komunikimit, zbatimi dhe aplikimi i analizës së rrezikut, sistemi i gjurmueshmërisë. Përshkrimi i proceseve dhe aplikimit të tyre përfshin të gjithë ato që janë zhvilluar nga kompania (edhe proceset e jashtme (outsourced) që duhen për të prodhuar/siguruar një produkt/shërbim të vecantë që është vendimtarë sepse ndikon në kapacitetin e produktit/shërbimit për të përmbushur kërkesat e aplikueshme).

Kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme:
-përshkrime
- grafikë dhe simbole
- tabela dhe matrica
- të tjera

- Marrja në konsideratë e kërkesave të standartit dhe përshkrimi, jo domosdoshmërisht i detajuar, i resurseve dhe procedurave që përdoren për të siguruar përputhje me këto kërkesa;
- Një përshkrimi i përshtatshëm i organizimit të kompanisë. Cdo informacion i marrë nga klienti është i konfidencial.

KAPITULLI 3 – CERTIFIKIMI FILLESTAR
3.1 Kompania që dëshiron të marrë një certifikim AQSCERT për Sistemin e tyre të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore duhet t'i sigurojë AQSCERT të dhënat kryesore të prodhimit/Kompanisë dhe vendndodhjen e siteve duke plotësuar Kërkesën për Ofertë (FO-C-001) që gjendet në faqen e internetit www.aqscert.org dhe t'ia dërgojë AQSCERT, që do e përdorë për të përgatitur një vlerësim.
Sidomos, kompania duhet të informojë AQSCERT
për:

- fushën e kërkuar për certifikim;
- informacion të përgjithshëm mbi kompaninë;
- numrin e siteve të përfshira në certifikim, bashkë me emrat, adresat dhe aktivitete relative që kryhen aty;
- Numrin e planeve HACCP që lidhen me fushën;
- Përfshirja me kompani më të mëdhaja, nëse ndodh;
- Certifikata të tjera, nëse ka;
- Përfshirja e konsulentëve të sistemit të menaxhimit, nëse ka.

3.2 Përvec cfarë është deklaruar në Rregulloren e Përgjitshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit (kapitulli 2.4) bashkë ose duke ndjekur kërkesën e certifikimit, Kompania duhet të bëjë të disponueshme këto dokumenta për AQSCERT:

- Dokumenti FO-C-001 Për Certifikimin Fillestar të plotësuar tërësisht, duke përfshirë tërë dokumentet e nevojshëm;
- Lista e autorizimeve sanitare/regjistrimeve EU që ka kompania.

AQSCERT shqyrton dokumentet e mësipërm për konformitet me standartin e referuar dhe për kërkesat e këtyre Rregullave.

3.3 Sic është deklaruar në pikën 2.5 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, gjatë fazës 1 të auditit, do kontrollohet saktësia e informacionit të dhënë nga Kompania në kërkesë ofertë.
Nëse ka ndryshime midis të dhënave fillestare të shkruara nga kompania në "Kërkesën për Ofertë" (FO-C-001) dhe të dhënave homologe të verifikuara gjatë fazës 1 të auditit nga grupi auditues, kohëzgjatja totale e auditit do rishikohet dhe modifikohet.
Në rast se kohëzgjatja e auditit, që del nga rishikimi, është më e gjatë se kohëzgjatja e përcaktuar më pare, klienti do komunikohet me e- mail ose forma te tjera komunikimi, me një lajmërim të posacëm që tregon kohëzgjatjen e re dhe të saktë të auditit. Nëse kompania nuk pranon kohëzgjatjen e re, kompania duhet t'i paguajë AQSCERT fazën 1 të auditit, sic ishte rënë dakord më përpara, të jap një arsye të përshtatshme brenda 10 ditë punë që nga marrja e lajmërimit dhe të pranojë ndërprerjen e procesit të certifikimit.
Në mungesë të përgjigjes nga ana e Kompanisë për lajmërimin e dërguar, do merret si të pranuara kushtet e reja, bazuar në të dhënat e verifikuara nga grupi i auditit dhe do prezantohen dhe diskutohen me transparencë në mbledhjen finale të fazës 1 të auditit.

KAPITULLI 4 – MIRËMBAJTJA E CERTIFIKIMIT

4.1 Përvec cfarë është deklaruar në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit (kapitulli 3.1), kompania duhet të mbajë regjistrime të:

- aspektet/impaktet e sigurisë ushqimore;
- cdo tërheqje ose anulim produktesh;
- aksidente/emergjenca në sit/et dhe ngjarje të tjera që mund të kenë pasur një impakt negativ në sigurinë e produktit;
- cdo ankesë të marrë në lidhje me impaktet e sigurisë ushqimore;
- cdo vëzhgim ose raport nga autoritete kombëtare ose vendase përgjegjëse për Kontrollin e sigurisë ushqimore dhe duhet t'i bëjë ato të disponueshme për AQSCERT bashkë me masat korrigjuese të implementuara gjatë auditëve periodik.

Kompania duhet të informojë AQSCERT për cdo observacion/vërejtje nga autoritetet kombëtare ose vendase përgjegjëse për kontrollin e sigurisë ushqimore dhe cdo situatë mospërputhjeje legjislative që ka lidhje me aktivitetet e kompanisë, pavarësisht fushës së aplikimit të Sistemit të Menaxhimit.

KAPITULLI 5 – REALIZIMI I AUDITËVE

5.1 TË PËRGJITHSHME

5.1.3 Përvec cfarë është përcaktuar në pikën 5.1.3 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit quhet edhe një Jo-Konformitet madhor një situatë që mund të kompromentojë sigurinë e produktit ushqimorë, mos ndjekja e kërkesave ligjore të prodhimit dhe të vendit të destinacionit dhe cdo situatë që mund të jetë e rrezikshme për klientët.
Gjithashtu, nëse nuk ka autorizime ose regjistrime të sitit, sic kërkohet nga legjislacioni, procesi i certifikimit pezullohet.

5.2. Auditi i certifikimit fillestar përbëhet nga dy faza (Faza 1 dhe Faza 2)

5.2.1. Faza 1

Si zëvendësim i cfarë është përmenduar në paragrafin 5.2.1. të Rregullores së Përgjithshme, Faza 1 e Auditit që kryhet në kompani ka si qëllimi:

- Të verifikojë dokumentacionin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore, duke përfshirë procedurat, përmbushin tërë kërkesat e standartit;

- Të vlerësojë nëse auditët e brendshëm dhe rishikimi nga menaxhmenti i lartë janë planifikuar dhe zbatuar në tërë sitet e kompanisë që mbulohen nga certifikimi.
- Rishikimin e statusit dhe të kuptuarit e klientit në lidhje me kërkesat e standartit, me referencë të vecantë identifikimit të performanacave kyc ose aspekte, procese, objektiva dhe operacione të rëndësishme për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore;
- Mbledhjen e informacionit të nevojshëm në lidhje me fushën e sistemit të menaxhimit, procese/vendndodhjen e klientit, duke përfshirë ligje dhe rregullore dhe zbatimi i tyre;
- Që kompania të ketë tërë autorizimet/licencat e nevojshme mbi Sigurinë Ushqimore dhe aktiviteteve të tij dhe që janë të vlefshme dhe në përputhje me ligjin në fuqi;
- Të hetojë sitet e Prodhimit/Kompaninë që të vlerësojë problemet e mundshme që nuk janë konsideruar nga Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të Kompanisë;
- Të rishikojë shpërndarjen e burimeve për fazën 2 të auditit dhe të pajtohet me detajet e klientit për fazën 2 të auditit;
- Të përqëndrohet në planifikimin e fazës 2, duke fituar informacion të mjaftueshëm mbi sistemin e menaxhimit, aktivitetet dhe sitin e klientit, me aspektet e mundshëm të rëndësishëm;
- Që SMSU (FSMS) ka qenë operacional për të paktën 3 muaj dhe që procedurat implementohen në mënyrë efikase.

Rezultati i fazës 1 të auditit është lënia në kompani e një kopieje të raportit të fazës 1 të auditit (FO-C-006), ku ndër të tjera, janë raportuar gjetje që mund të jenë hasur, duke përfshirë edhe ato që klasifikohen si jo-konformitete (madhore ose minore) për fazën 2 të auditit. Veprimet që merren nga Kompania për zgjidhjen e këtyre gjetjeve verifikohen gjatë fazës 2 të auditit në paragrafin 5.2.2
Në rast të jo-konformiteteve që janë kritike, grupi i auditit që kryen fazën 1 të auditit vendos nëse duhet të zgjidhen para kryerjes së Fazës 2 të auditit të kompanisë. Në rast të fazave 1 dhe 2 të njëpasnjëshme të auditit, Faza 2 duhet të ri-programohet dhe të shtyhet në një datë që nuk i kalon 3 muaj nga data e fazës së parë të auditit.

5.2.2.Faza 2
Si zëvendësim i cfarë është përmendur në paragrafin korrespondues 5.2.2 të Rregullores së përgjithshme, faza 2 e auditit tek kompania duhet kryer brenda një periudhe maksimumi prej 3 muajsh që nga përfundimi i fazës 1 të auditit.
Faza 2 e auditit në kompani kryhet për të verifikuar implementimin korrekt dhe efektiv të Sistemit të Menaxhimit.
AQSCERT i dërgon kompanisë, para fazës së dytët të audit në sit/e, një plan auditi, në të cilin është dhënë me detaje, përshkrimi i aseteve dhe mjeteve për zhvillimin e auditit. Nëse aktivitetet do kontrollohen në disa site, auditi zhvillohet sipas kritereve të përcaktuar më përpara dhe të komunikuar nga AQSCERT.

Faza 2 e auditit kryhet nga një grup auditi i AQSCERT bazuar në raportin e fazës 1 të auditit dhe në dokumentet e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të përgatitur nga kompania në një rishikim të përditësuar.

Faza 2 e auditit përbëhet nga:
- Një takim fillestar me Teknikët e Organizatës që të vendosen fusha dhe metodat e auditit dhe që të konfirmohet plani i auditit;
- Një rishikimi i implementimit të masave efektive të adaptimit në lidhje me vërejtjet e bëra gjatë fazës 1 të auditit;
- Një inspektim i sitit/eve të prodhimit/Kompanisë që të verifikohet pajtueshmëria me dokumentet referencë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore;
- Një mbledhje përfundimtare për të sqaruar rezultatet e vlerësimit.

Me perfundimin e auditit faza 2, kompanisë i dorëzohet një raport audit (FO-C-008). Në prani të moskonformiteteve të mëdha (gjetjet e tipit A), procesi i certifikimit pezullohet; në rastin e moskonformiteteve të vogla numri i të cilit, sipas mendimit të grupit të auditimit, është i tillë që të paragjykojë funksionimin korrekt të Sistemit të Menaxhimit, procesi i certifikimit pezullohet gjithashtu.
Në raste të tilla, brenda tre muajve, AQSCERT duhet të kryejë një auditim shtesë që ka për qëllim verifikimin e efektivitetit të trajtimeve dhe të veprimeve korrigjuese të propozuara; pas përfundimit të suksesshëm të këtij auditimi, ndodh rifillimi i procesit të certifikimit.
Auditimi shtesë mund të kryhet në vend ose në baza dokumentare bazuar në llojin e veprimeve korrigjuese që duhet të verifikohen sipas mendimit të ekipit të auditimit.
Të gjitha shpenzimet në lidhje me çdo auditim shtesë që rezulton nga mangësitë në Sistemin e Menaxhimit janë në ngarkim të kompanisë kliente.
Nëse afati i lartpërmendur është tejkaluar, Sistemi i Menaxhimit të Organizatës duhet të jetë subjekt i një auditimi brenda një periudhe

prej dymbëdhjetë muajsh nga data e përfundimit të fazës 2 të auditimit, duke përdorur kriteret (metodat dhe kohën e auditimit) të parashikuara për një auditim të fazës 2.

Nëse periudha e mësipërme dymbëdhjetë mujore kalon pa përfundim pozitiv të vlerësimit, AQSCERT mund të konsiderojë të mbyllur procedurën e certifikimit, duke ngarkuar kohën dhe shpenzimet e bëra deri në atë kohë.
Në raste të tilla kompania që dëshiron të vazhdojë me certifikimin duhet të paraqesë një kërkesë të re dhe të përsërisë procesin e certifikimit.
Kufijtë e lartpërmendur mund të ndryshohen në raste të veçanta me kërkesë të arsyetuar nga kompania, dhe të gjykuar nga AQSCERT.

KAPITULLI 8 – KOMPANI ME SHUMË SITE

8.1 Si zëvendësim i paragrafit 8.1 i Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemit të Menaxhimit, kur një kompani operon në site të shumëfishtë dhe tërë funksionet që kanë lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore kontrollohen nga një zyrë qëndrore dhe kërkohet një certifikatë e vetme, auditi mund të zhvillohet duke marrë mostra të siteve që do auditohen vetëm për kategoritë që lejohen nga ISO / TS 22003:2013 dhe nëse numri i siteve i kalon 20, me kusht që:

- Aktiviteti që do certifikohet është i njëjtë për të tëra sitet dhe kompania aplikon të njëjtin Sistem Menaxhimi të Sigurisë Ushqimore (të kontrolluar nga një sit qëndror) për të gjitha sitet;
- Në të tërë sitet produktet/shërbimet e Kompanisë janë në thelb të të njëjtit lloj dhe bëhen me të njëjtat metoda dhe procedura dhe tërë sitet ndodhen në të njëjtin shtet;
- Aktivitetet e mëposhtme menaxhohen nga zyrat qëndrore të Kompanisë:
  - Procedurat e Komunikimit;
  - Përgjigjet e Menaxhimit dhe të emergjencave;
  - Analiza e rreziqeve dhe identifikimi i rreziqeve shoqëruese;
  - Sistemi i gjurmueshmërisë;
  - Vlerësimi i kërkesave për trajnime;
  - Kontrolli i dokumentave dhe ndryshimeve të tyre;
  - Rishikimi i sistemit të menaxhimit nga menaxhmenti i lartë;
  - Vlerësimi i efektivitetit të masave korrigjuese dhe parandaluese;
  - Planifikimi/zbatimi i auditëve të brendshëm dhe vlerësimi i rezultateve të tyre;
  - Para auditit nga AQSCERT, kompania duhet të ketë kryer audit të brendshëm në cdo sit;

8.2 Si zëvendësim i pikës 8.2 i Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemit të Menaxhimit, gjatë auditit për certifikim fillestar, mirëmbajtje, dhe ri-certifikim do merren mostra në përputhje me ISO/TS 22003:2013.

SEKSIONI 2: CERTIFIKIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË USHQIMORE NË KONFORMITET ME ISO 22000:2005

KAPITULLI 1 – TË PËRGJITHSHME

1.1 Këto rregulla përcaktojnë procedurat shtesë ose zëvendësuese të zbatuara nga AQSCERT për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit
të Sigurisë Ushqimore në lidhje me cfarë është e përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit. Paragrafët e këtyre Rregullave u referohen paragrafëve korrespondues të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, në të cilat janë bërë ndryshime dhe/ose shtesa.

1.2 AQSCERT u lëshon certifikime sipas kërkesave të standartit ISO/IEC 17021:2015 kompanive, Sistemi i Menaxhimit të të cilave është pranuar që është konform të gjitha kërkesave të standartit ISO 22000:2005.
Certifikimet ISO 22000:2005 mund të lëshohen deri në fund të periudhës së tranzicionit.
Certifikimet të lëshuara dhe të ri-lëshuara në konformitet me ISO 22000:2005 skadojnë në 18 qershor 2021, data e fundit të përiudhës së tranzicionit.
Azhornim: Për shkak të pandemisë Covid-19, data e skadencës është shtyrë me 6 muaj, duke skaduar në 29 dhjetor 2021.
Që të mbajë sistemin e menaxhimit të sigurisë Ushqimore, një Kompani që është certifikuar sipas ISO 22000:2005 duhet të kryejë kalimin në versionin e ri të ISO 22000:2018 sipas seksionit 3 të rregullave të AQSCERT, brenda 18 qershor 2021.
Azhornim: Për shkak të pandemisë Covid-19, data e skadencës është shtyrë me 6 muaj, duke skaduar në 29 dhjetor 2021.

KAPITULLI 2 – STANDARTI REFERENCË / KËRKESAT E CERTIFIKIMIT

2.1 Përvec cfarë është deklaruar në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, për të marrë një certifikim AQSCERT një Sistem i Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore në fillim duhet të përmbush kërkesat e ISO 22000 dhe kërkesat shtesë, nëse ka, të organizmave akreditues.

2.2 Si zëvendësim i cfarë është përcaktuar në paragrafin 1.2 të Rregullores së përgjithshme, në vecanti, për të arritur certifikimin e sistemit të menaxhimit, Kompania duhet të ketë përgatitur Dokumentacionin, i cili është:

- Përcaktimi i objektivave/qëllimit/fushës së aplikimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore, duke përshkruar proceset kryesore midis të cilave protokollet e komunikimit, zbatimi dhe aplikimi i analizës së rrezikut, sistemi i gjurmueshmërisë.

Përshkrimi i proceseve dhe aplikimit të tyre përfshin të gjithë ato që janë zhvilluar nga kompania (edhe proceset e jashtme (outsourced) që duhen për të prodhuar/siguruar një produkt/shërbim të vecantë që është vendimtarë sepse ndikon në kapacitetin e produktit/shërbimit për të përmbushur kërkesat e aplikueshme).
Kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme:

- përshkrime
- grafikë dhe simbole
- tabela dhe matrica
- të tjera

- Marrja në konsideratë e kërkesave të standartit dhe përshkrimi, jo domosdoshmërisht i detajuar, i resureseve dhe procedurave që përdoren për të siguruar përputhje me këto kërkesa;
- Një përshkrimi i përshtatshëm i organizimit të kompanisë. Cdo informacion i marrë nga klienti është konfidencial.

KAPITULLI 3 – CERTIFIKIMI FILLESTAR

3.1 Kompania që dëshiron të marrë një certifikim AQSCERT për Sistemin e tyre të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore duhet t'i sigurojë AQSCERT të dhënat kryesore të prodhimit/Kompanisë dhe vendndodhjen e siteve duke plotësuar "Kërkesën për Ofertë" (FO-C-001) që gjendet në faqen e internetit www.aqscert.org dhe t'ia dërgojë AQSCERT , që do e përdorë për të përgatitur një vlerësim.
Sidomos, kompania duhet të informojë AQSCERT
për:

- fushën e kërkuar për certifikim;
- informacion të përgjithshëm mbi kompaninë
- numrin e siteve të përfshira në certifikim, bashkë me emrat, adresat dhe aktivitete relative që kryhen aty;
- Numrin e planeve HACCP që lidhen me fushën;
- Përfshirja me kompani më të mëdhaja, nëse ndodh;
- Certifikata të të tjera, nëse ka;
- Përfshirja e konsulentëve të sistemit të menaxhimit, nëse ka.

3.2 Sic është deklaruar në pikën 2.5 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, gjatë fazës 1 të auditit, do kontrollohet saktësia e informacionit të dhënë nga Kompania në Kërkesën për Ofertë (FO-C-001).
Nëse ka ndryshime midis të dhënave fillestare të shkruara nga kompania në dokumentin FO-C-001 dhe të dhënave homologe të verifikuara gjatë fazës 1 të auditit nga grupi audities, kohëzgjatja totale e auditit do rishikohet dhe modifikohet.
Në rast se kohëzgjatja e auditit, që del nga rishikimi, është më e gjatë se kohëzgjatja e përcaktuar më para, klienti do komunikohet me e- mail me një lajmërim të posacëm që tregon kohëzgjatjen e re dhe të saktë të auditit. Nëse kompania nuk pranon kohëzgjatjen e re, kompania duhet t'i paguajë AQSCERT fazën 1 të auditit, sic ishte rënë dakord më përpara, të jap një arsye të përshtatshme brenda 10 ditë punë që nga marrja e lajmërimit dhe të pranojë ndërprerjen e procesit të certifikimit.
Në mungesë të përgjigjes nga ana e Kompanisë për lajmërimin e dërguar, do merret si të pranuara kushtet e reja, bazuar në të dhënat e verifikuara nga grupi i auditit dhe do prezantohen dhe diskutohen
me transparencë në mbledhjen finale të fazës 1 të
auditit.

KAPITULLI 4 – MIRËMBAJTJA E CERTIFIKIMIT

4.1 Përvec cfarë është deklaruar në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit (kapitulli 3.1), kompania duhet të mbajë regjistrime të:

- aspektet/impaktet e sigurisë ushqimore;
- cdo tërheqje ose anulim produktesh;
- aksidente/emergjenca në sit/et dhe ngjarje të tjera që mund të kenë pasur një impakt negativ në sigurinë e produktit;
- cdo ankesë të marrë në lidhje me impaktet e sigurisë ushqimore;
- cdo vëzhgim ose raport nga autoritete kombëtare ose vendase përgjegjëse për Kontrollin e sigurisë ushqimore dhe duhet t'i bëjë ato të disponueshme për AQSCERT bashkë me masat korrigjuese të implementuara gjatë auditëve periodik.

Kompania duhet të informojë AQSCERT për cdo observacion/vërejtje nga autoritetet kombëtare ose vendase përgjegjëse për kontrollin e sigurisë ushqimore dhe cdo situatë mospërputhjeje legjislative që ka lidhje me aktivitete e kompanisë, pavarësisht fushës së aplikimit të Sistemit të Menaxhimit.

KAPITULLI 5 – REALIZIMI I AUDITËVE

5.1 TË PËRGJITHSHME

5.1.3 Përvec cfarë është përcaktuar në pikën 5.1.3 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit quhet edhe një Jo-Konformitet madhor një situatë që mund të kompromentojë sigurinë e produktit ushqimorë, mos ndjekja e kërkesave ligjore të prodhimit dhe të vendit të destinacionit dhe cdo situatë që mund të jetë e rrezikshme për klientët.
Gjithashtu, nëse nuk ka autorizime ose regjistrime të sitit, sic kërkohet nga legjislacioni, procesi i certifikimit pezullohet.

5.2. Auditi i certifikimit fillestar përbëhet nga dy faza (Faza 1 dhe Faza 2)

5.2.1. Faza 1
Si zëvendësim i cfarë është përmenduar në paragrafin 5.2.1. të Rregullores së Përgjithshme, Faza 1 e Auditit që kryhet në kompani ka si qëllimi:

- Të verifikojë dokumentacionin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore, duke përfshirë procedurat, përmbushin tërë kërkesat e standartit;
- Të vlerësojë nëse auditët e brendshëm dhe rishikimi nga menaxhmenti i lartë janë planifikuar dhe zbatuar në tërë sitet e kompanisë që mbulohen nga certifikimi.
- Rishikimin e statusit dhe informimin e klientit në lidhje me kërkesat e standartit, me referencë të vecantë identifikimit të performancave kyc ose aspekte, procese, objektiva dhe operacione të rëndësishme për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore;
- Mbledhjen e informacionit të nevojshëm në lidhje me fushën e sistemit të menaxhimit, procese/vendndodhjen e klientit, duke përfshirë ligje dhe rregullore dhe zbatimi i tyre;
- Që kompania të ketë tërë autorizimet/licencat e nevojshme mbi Sigurinë Ushqimore dhe aktiviteteve të tij dhe që janë të vlefshme dhe në përputhje me ligjin në fuqi;
- Të hetojë sitet e Prodhimit/Kompaninë që të vlerësojë problemet e mundshme që nuk janë konsideruar nga Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të Kompanisë;
- Të rishikojë shpërndarjen e burimeve për fazën 2 të auditit dhe të pajtohet me detajet e klientit për fazën 2 të auditit;
- Të përqëndrohet në planifikimin e fazës 2, duke fituar informacion të mjaftueshëm mbi sistemin e menaxhimit, aktivitetet dhe sitin e klientit, me aspektet e mundshëm të rëndësishëm;
- Që SMSU (FSMS) ka qenë operacional për të paktën 3 muaj dhe që procedurat implementohen në mënyrë efikase.

Rezultati i fazës 1 të auditit është lënia në kompani e një kopieje të raportit të fazës 1 të auditit (FO-C-006), ku ndër të tjera, janë raportuar gjetje që mund të jenë hasur, duke përfshirë edhe ato që klasifikohen si jo-konformitete (madhore ose minore) për fazën 2 të auditit. Veprimet që merren nga Kompania për zgjidhjen e këtyre gjetjeve verifikohen gjatë fazës 2 të auditit në paragrafin 5.2.2
Në rast të jo-konformiteteve që janë kritike, grupi i auditit që kryen fazën 1 të auditit vendos nëse duhet të zgjidhen para kryerjes së Fazës 2 të auditit të kompanisë. Në rast të fazave 1 dhe 2 të njëpasnjëshme të auditit, Faza 2 duhet të ri-programohet dhe të shtyhet në një datë që nuk i kalon 3 muaj nga data e fazës së parë të auditit.

5.2.2. Faza 2
Si zëvendësim i cfarë është përmendur në paragrafin korrespondues 5.2.2 të Rregullores së përgjithshme, faza 2 e auditit tek kompania duhet kryer brenda një periudhe maksimumi prej 3 muajsh që nga përfundimi i fazës 1 të auditit.
Faza 2 e auditit në kompani kryhet për të verifikuar implementimin korrekt dhe efektiv të Sistemit të Menaxhimit.
AQSCERT i dërgon kompanisë, para fazës së dytët të audit në sit/e, një plan auditi (FO-C-007), në të cilin është dhënë me detaje, përshkrimi i aseteve dhe mjeteve për zhvillimin e auditit. Nëse aktivitetet do kontrollohen në disa site, auditi zhvillohet sipas kritereve të përcaktuar më përpara dhe të komunikuar nga AQSCERT.

Faza 2 e auditit kryhet nga një grup auditi i AQSCERT bazuar në raportin e fazës 1 të auditit dhe në dokumentet e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të përgatitur nga kompania në një rishikim të përditësuar.

Faza 2 e auditit përbëhet nga:

- Një takim fillestar me Teknikët e Organizatës që të vendosen fusha dhe metodat e auditit dhe që të konfirmohet plani i auditit;
- Një rishikimi i implementimit të masave efektive të adaptimit në lidhje me vërejtjet e bëra gjatë fazës 1 të auditit;
- Një inspektim i sitit/eve të prodhimit/Kompanisë që të verifikohet pajtueshmëria me dokumentet referencë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore;
- Një mbledhje përfundimtare për të sqaruar rezultatet e vlerësimit.

Me perfundimin e auditit faza 2, kompanisë i dorëzohet një raport audit (FO-C-008). Në prani të moskonformiteteve të mëdha (gjetjet e tipit A), procesi i certifikimit pezullohet; në rastin e moskonformiteteve të vogla numri i të cilit, sipas mendimit të grupit të auditimit, është i tillë që të paragjykojë funksionimin korrekt të Sistemit të Menaxhimit, procesi i certifikimit pezullohet gjithashtu.
Në raste të tilla, brenda gjashtë muajve, AQSCERT duhet të kryejë një auditim shtesë që ka për qëllim verifikimin e efektivitetit të trajtimeve dhe të veprimeve korrigjuese të propozuara; pas përfundimit të suksesshëm të këtij auditimi, ndodh rifillimi i procesit të certifikimit.
Auditimi shtesë mund të kryhet në vend ose në baza dokumentare bazuar në llojin e veprimeve korrigjuese që duhet të verifikohen sipas mendimit të ekipit të auditimit.
Të gjitha shpenzimet në lidhje me çdo auditim shtesë që rezulton nga mangësitë në Sistemin e Menaxhimit janë në ngarkim të kompanisë kliente.
Nëse afati i lartpërmendur është tejkaluar, Sistemi i Menaxhimit të Organizatës duhet të jetë subjekt i një auditimi brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh nga data e përfundimit të fazës 2 të auditimit, duke përdorur kriteret (metodat dhe kohën e auditimit) të parashikuara për një auditim të fazës 2.
Nëse periudha e mësipërme dymbëdhjetë mujore kalon pa përfundim pozitiv të vlerësimit, AQSCERT mund të konsiderojë të mbyllur procedurën e certifikimit, duke ngarkuar kohën dhe shpenzimet e bëra deri në atë kohë.
Në raste të tilla kompania që dëshiron të vazhdojë me certifikimin duhet të paraqesë një kërkesë të re dhe të përsërisë procesin e certifikimit.
Kufijtë e lartpërmendur mund të ndryshohen në raste të veçanta me kërkesë të arsyetuar nga kompania, dhe të gjykuar nga AQSCERT.

KAPITULLI 6 – MENAXHIMI I CERTIFIKATAVE TË KONFORMITETIT

6.1 Certifikatat ISO 22000:2005 skadojnë në 18 qershor 2021.
Azhornim: Për shkak të pandemisë Covid-19, data e skadencës është shtyrë me 6 muaj, duke skaduar në 29 dhjetor 2021.

KAPITULLI 8 – KOMPANI ME SHUMË SITE

8.1 Si zëvendësim i paragrafit 8.1 i Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemit të Menaxhimit, kur një kompani operon në site të shumëfishtë dhe tërë funksionet që kanë lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore kontrollohen nga një zyrë qëndrore dhe kërkohet një certifikatë e vetme, auditi mund të zhvillohet duke marrë mostra të siteve që do auditohen vetëm për kategoritë që lejohen nga ISO / TS 22003:2013 dhe nëse numri i siteve i kalon 20, me kusht që:

- Aktiviteti që do certifikohet është i njëjtë për të tëra sitet dhe kompania aplikon të njëjtin Sistem Menaxhimi të Sigurisë Ushqimore (të kontrolluar nga një sit qëndror) për të gjitha sitet;
- Në të tërë sitet produktet/shërbimet e Kompanisë janë në thelb të të njëjtit lloj dhe bëhen me të njëjtat emtoda dhe procedura dhe tërë sitet ndodhen në të njëjtin shtet;
- Aktivitetet e mëposhtme menaxhohen nga zyrat qëndrore të Kompanisë:
  - Procedurat e Komunikimit;
  - Përgjigjet e Menaxhimit dhe të emergjencave;
  - Analiza e rreziqeve dhe identifikimi i rreziqeve shoqëruese;
  - Sistemi i gjurmueshmërisë;
  - Vlerësimi i kërkesave për trajnime;
  - Kontrolli i dokumentave dhe ndryshimeve të tyre;
  - Rishikimi i sistemit të menaxhimit nga menaxhmenti i lartë;
  - Vlerësimi i efektivitetit të masave korrigjuese dhe parandaluese;
  - Planifikimi/zbatimi i auditëve të brendshëm dhe vlerësimi i rezultateve të tyre;
  - Para auditit nga AQSCERT, kompania duhet të ketë kryer audit të brendshëm në cdo sit.

8.2 Si zëvendësim i pikës 8.2 i Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemit të Menaxhimit, gjatë auditit për certifikim fillestar, mirëmbajtje, dhe ri-certifikim do merren mostra në përputhje me ISO/TS 22003:2013.

SEKSIONI 3: KALIMI (TRANZICIONI) I CERTIFIKIMIT NGA ISO 22000:2005 NË ISO 22000:2018

A.0 TË PËRGJITHSHME

Ky seksion aplikohet kur një Kompani e certifikuar sipas ISO 22000:2005 kërkon kalimin në versionin e ri të standartit ISO 22000:2018.
Që të merret certifikimi AQSCERT ISO 22000:2018, një Sistem i Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore duhet të përmbush kërkesat e ISO 22000:2018 dhe kërkesat shtesë të organizmave akreditues.
Kompania duhet të tregojë që ka implementuar në mënyrë të saktë dhe ka zbatuar ndryshimet:

- të ketë konsideruar kontekstin dhe përcaktuar fushën e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore dhe planifikimi i sistemit të menaxhimit bazuar në rreziqe dhe oportunitete;
- Që planifikimi dhe kontrolli operacional i sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore është në përputhje me perspektivën e ciklit të jetës.

A.1 APLIKIMI PËR KALIM (TRANZICION)

Gjatë periudhës së tranzicionit, Kompania e certifikuar mund të vendosë të kryejë kalimin në standartin e ri:
1. gjatë auditit të mirëmbajtjes (me rritje të kohëzgjatjes së auditit);
2. gjatë auditit të ricertifikimit;
3. ndërmjet dy auditeve të certifikuara.

Një përfaqësues i autorizuar i kompanisë aplikuese duhet të paraqesë një kërkesë tranzicioni për AQSCERT.
Me marrjen e kërkesës për tranzicion, AQSCERT i dërgon Kompanisë dokumentin FO-C-001 "Kërkesë për Ofertë" që duhet plotësuar, bashkë me dokumentet e nevojshëm.
Sipas informacionit të shkruar në dokumentin "Kërkesë për Ofertë", AQSCERT vendos nëse është e mundur të bëhet kalimi dhe në rast të një rritjeje të kohëzgjatjes së auditit, përgatit një ofertë ekonomike për auditin e kalimit.

A.2 REALIZIMI I AUDITËVE

Auditi i tranzicionit ndahet në dy hapa:

- rishikimi dokumentacionit të elementëve të ndryshuar bazuar në "Kërkesën për Ofertë" dhe në informacionin e dokumentuar të kërkuar nga ISO 22000:2018;
- Audit on-site për të vlerësuar përmbushjen e kërkesave të reja të ISO 22000:2018.

Në lidhje me zhvillimin e auditëve, aplikohet cfarë është përcaktuar në Rregulla të Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit (kapitulli 5).

Gjatë periudhës së tranzicionit, nëse është ngritur ndonjë jo-konformitet madhor sipas ISO 22000:2018 dhe nuk është mbyllur brenda afateve të përcaktuara në Rregulla të Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, këto jo-konformitete nuk do ndikojnë negativisht mirëmbajtjen e certifikimit aktual, me kusht që të verifikohet që Sistemi i Sigurisë Ushqimore është gjithmonë në përputhje me ISO 22000:2005.
Datat dhe shtesat e auditëve vijues për mirëmbajtjen e certifikimit mbeten të njëjta si ato të programit 3-vjecar.
Azhornim: Për shkak të pandemisë Covid-19, data e skadencës është shtyrë me 6 muaj, duke skaduar në 29 dhjetor 2021.

A.3 LËSHIMI I CERTIFIKATËS NË KONFORMITET ME ISO 22000:2018

Pas rezultatit pozitiv të auditit të tranzicionit dhe miratimit nga AQSCERT, një certifikatë konformiteti me një version të ri të standartit lëshohet; vlefshmëria do llogaritet në bazë të datave të mëparshme të certifikimit/ricertifikimit.

A.4 VLEFSHMËRIA E CERTIFIKATAVE NË KONFORMITET ME ISO 22000:2018

Certifikatat ISO 22000:2005 skadojnë në 18 qershor 2021.
Azhornim: Për shkak të pandemisë Covid-19, data e skadencës është shtyrë me 6 muaj, duke skaduar në 29 dhjetor 2021.
Pas skadencës së certifikatës ISO 22000:2005, një kompani që ka nevojë për një certifikim ISO 22000:2018, duhet të paraqesë një aplikim të ri për certifikim duke ndjekur kërkesat e certifikimit fillestar.

SEKSIONI 4 – CERTIFIKIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË USHQIMORE SIPAS SKEMËS FSSC 22000 V.4.1

KAPITULLI 1 – TË PËRGJITHSHME

1.1 Këto rregulla përcaktojnë procedurat shtesë ose zëvendësuese të zbatuara nga AQSCERT për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore dhe specifikimet e sektorit teknik (kërkesa paraprake) në lidhje me cfarë është përcaktuar në Rregulloren të Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit.
Paragrafët e këtyre Rregullave i referohen paragrafëve korrespondues të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, në të cilat janë bërë ndryshime dhe/ose shtesa.

1.2 AQSCERT u lëshon certifikime, sipas kërkesave të standartit ISO/IEC 17021:2015, kompanive Sistemi i Menaxhimit të të cilave është pranuar që është konform të gjitha kërkesave të skemës FSSC 22000 v.4.1.

KAPITULLI 2 – STANDARTI REFERENCE / KËRKESAT E CERTIFIKIMIT

2.1 Përvec cfarë është deklaruar në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, kompanitë që dëshirojnë të marrin një certifikim AQSCERT për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore në fillim duhet të përmbushin kërkesat e ISO 22000 dhe kërkesat shtesë, (p.sh specifikimet e sektorit teknik-kërkesa paraprake si ato të ISO/TS 22002-1), nëse kërkohet nga organizmat certifikues dhe/ose nga organizata private që menaxhojnë standartin (FSSC 22000, për detaje www.FSSC22000.com)

2.2 Si zëvendësim i cfarë është përcaktuar në paragrafin 1.2 të Rregullave të përgjithshme, në vecanti, për të arritur certifikimin e sistemit të menaxhimit, Kompania duhet të ketë përgatitur Dokumentacionin, i cili është:

- Përcaktimi i objektivave/qëllimit/fushës së aplikimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore, duke përshkruar proceset kryesore midis të cilave protokollet e komunikimit, zbatimi dhe aplikimi i analizës së rrezikut, sistemi i gjurmueshmërisë. Përshkrimi i proceseve dhe aplikimit të tyre përfshin të gjithë ato që janë zhvilluar nga kompania (edhe proceset e jashtme (outsourced) që duhen për të prodhuar/siguruar një produkt/shërbim të vecantë që është vendimtarë sepse ndikon në kapacitetin e produktit/shërbimit për të përmbushur kërkesat e aplikueshme).

Kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme:
- përshkrime
- grafikë dhe simbole
- tabela dhe matrica
- të tjera

- Marrja në konsideratë e kërkesave të standartit dhe përshkrimi, jo domosdoshmërisht i detajuar, i resureseve dhe procedurave që përdoren për të siguruar përputhje me këto kërkesa;
- Një përshkrimi i përshtatshëm i organizimit të kompanisë. Cdo informacion i marrë nga klienti është konfidencial.

2.3 Për certifikimin specifik FSSC 22000, përvec cfarë është përmendur më lartë, aplikohen rregullat e mëposhtme:

- Kontrata midis AQSCERT dhe kompanise për FSSC 22000, duhet të përfshijë gjithmonë tarifat për certifikim që duhet të paguhen cdo vit tek Fondacioni FSSC;
- AQSCERT duhet t'i paraqesë Fondacionit FSSC informacionin e mëposhtëm (brenda 4 javëve pas lëshimit të certifikatës):
  - emri dhe vendndodhje e kompanisë së certifikuar, o fusha e certifikimit;
  - data e certifikimit fillestar,
  - data e skadencës së certifikatës,
  - në rast pezullimi ose tërheqjeje, datën e pezullimit ose tërheqejes.

Këto informacione për kompanitë e certifikuara do bëhen publike në faqen online të Fondacionit FSSC.

- Kompania e certifikuar duhet të lajmërojë AQSCERT për cdo ndjekje ligjore mbi sigurinë ushqimore, jo-konformitete të rëndësishme rregullatore për sigurinë ushqimore, ose cdo tërheqje produkti në lidhje me sigurinë ushqimore. AQSCERT duhet të lajmërohet në mënyrë të menjëhershme;
- Kompania e certifikuar do informojë AQSCERT, që ka të drejtën të hetojë cështjen që të sigurojë integritetin e certifikimit pas një lajmërimi të tillë:
- menjëherë pas cdo ndjekje ligjore mbi sigurinë ushqimore, jo-konformitete të rëndësishme rregullatore për sigurinë ushqimore, ose cdo tërheqje produkti në lidhje me sigurinë ushqimore,
- menjëherë pas ngjarjeve serioze që ndikojnë në sigurinë ushqimore dhe/ose integritetin e certifikimit dhe hyrjen e kompanisë në FSSC 22000 Regjistër i kompanive të Certifikura;
- Brenda 3 ditëve pune, të ndryshimeve të rëndësishme që ndikojnë në aftësinë e sistemit të menaxhimit që të vazhdojë përmbushjen e kërkesave të skemës.

- Aktivitetet e certifikimit që kanë lidhje me kategoritë e fushëveprimit për të cilat AQSCERT është e akredituar kryhen në përputhje me rregullat e aplikueshme të akreditimit dhe certifikatat e lëshuara kanë logon e Organizmit përkatës të Akreditimit.
- Në rast të ndryshimeve dhe/ose lajmërimeve nga Fondacioni FSSC në lidhje me kërkesat e skemës FSSC 22000, kompania e certifikuar do informohet brenda një periudhe 2 mujore. Rregullat do zbatohen në përputhje me rrethanat.

KAPITULLI 3 – CERTIFIKIM FILLESTAR

3.1 Kompania që dëshiron të marrë një certifikim AQSCERT për Sistemin e tyre të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore duhet t'i sigurojë AQSCERT të dhënat kryesore të prodhimit/Kompanisë dhe vendndodhjen e siteve duke plotësuar "Kërkesën për Ofertë" (FO-C-001) që gjendet në faqen e internetit www.aqscert.org dhe t'ia dërgojë AQSCERT , që do e përdorë për të përgatitur një vlerësim.
Sidomos, kompania duhet të informojë AQSCERT për:

- fushën e kërkuar për certifikim;
- informacion të përgjithshëm mbi kompaninë
- numrin e siteve të përfshira në certifikim, bashkë me emrat, adresat dhe aktivitete relative që kryhen aty;
- Numrin e planeve HACCP që lidhen me fushën;
- Përfshirja me kompani më të mëdhaja, nëse ndodh;
- Certifikata të të tjera, nëse ka;
- Përfshirja e konsulentëve të sistemit të menaxhimit, nëse ka.

3.2 Sic është deklaruar në pikën 2.5 të Rregullave të përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, gjatë fazës 1 të auditit, do kontrollohet saktësia e informacionit të dhënë nga Kompania në pyetësorin informativë.
Nëse ka ndryshime midis të dhënave fillestare të shkruara nga kompania në dokumentin FO-C-001 dhe të dhënave homologe të verifikuara gjatë fazës 1 të auditit nga grupi auditues, kohëzgjatja totale e auditit do rishikohet dhe modifikohet.
Në rast se kohëzgjatja e auditit, që del nga rishikimi, është më e gjatë se kohëzgjatja e përcaktuar më para, klienti do komunikohet me e-mail me një lajmërim të posacëm që tregon kohëzgjatjen e re dhe të saktë të auditit. Nëse kompania nuk pranon kohëzgjatjen e re, kompania duhet t'i paguajë AQSCERT fazën 1 të auditit, sic ishte rënë dakord më përpara, të jap një arsye të përshtatshme brenda 10 ditë punë që nga marrja e lajmërimit dhe të pranojë ndërprerjen e procesit të certifikimit.
Në mungesë të përgjigjes nga ana e Kompanisë për lajmërimin e dërguar, do merret si të pranuara kushtet e reja, bazuar në të dhënat e verifikuara nga grupi i auditit dhe do prezantohen dhe diskutohen
me transparencë në mbledhjen finale të fazës 1 të auditit.

3.3 Versioni FSSC 22000 4.1, i detyrueshëm që nga 1 janari 2018 për tërë certifikimet fillestare, auditët e mirëmbajtjet dhe ricertifikimet, ka futur një mirëmbajtje të palajmëruar.
Të paktën një nga 2 mirëmbajtjet e duhet të planifikohet që të kryhet pa lajmërim. AQSCERT vendos vendos se cili nga auditët e programuar do jetë auditi i palajmëruar. Kompania e certifikuar mund të zgjedh me dëshirë që të zëvendësoj tërë audittë e mirëmbajtjes me auditët mirëmbajtje të palajmëruar.
Nëse kompania e certifkuar refuzon të marrë pjesë në auditin e palajmëruar, certifikata do pezullohet mënjeherë, dhe AQSCERt do tërheq certifikatën, nëse auditi i palajmëruar nuk kryhet brenda 3 muajsh.
Nëse auditor i mohohet hyrja kompania e certifikuar do jetë përgjegjëse për tërë shpenzimet.

KAPITULLI 4 – MIRËMBAJTJA E CERTIFIKIMIT

4.1 Përvec cfarë është deklaruar në Rregulloren e Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit (kapitulli 3.1), kompania duhet të mbajë regjistrime të:

- aspektet/impaktet e sigurisë ushqimore;
- cdo tërheqje ose anulim produktesh;
- aksidente/emergjenca në sit/et dhe ngjarje të tjera që mund të kenë pasur një impakt negativ në sigurinë e produktit;
- cdo ankesë të marrë në lidhje me impaktet e sigurisë ushqimore;
- cdo vëzhgim ose raport nga autoritete kombëtare ose vendase përgjegjëse për Kontrollin e sigurisë ushqimore dhe duhet t'i bëjë ato të disponueshme për AQSCERT bashkë me masat korrigjuese të implementuara gjatë auditëve periodik.

Kompania duhet të informojë AQSCERT për cdo observacion/vërejtje nga autoritetet kombëtare ose vendase përgjegjëse për kontrollin e sigurisë ushqimore dhe cdo situatë mospërputhjeje legjislative që ka lidhje me aktivitete e kompanisë, pavarësisht fushës së aplikimit të Sistemit të Menaxhimit.

KAPITULLI 5 – REALIZIMI I AUDITIT

5.1 TË PËRGJITHSHME

5.1.3. Si zëvendësim i paragrafit 5.1.3 i Rregullores së Përgjithshme për Certifkimin e Sistemeve të Menaxhimit, një raport i shkruar duhet përgatitur për cdo audit, në të cilin tregohen jo-konformitetet kritike, jo-konformitetet madhor dhe cdo jo-konformitet minor. Një jo-konformitet minor lëshohet kur gjetja nuk ndikon në aftësitë e sistemit të menaxhimit për të arritur rezultatet e synuara:

1) Kur një jo-konformitet minor lëshohet gjatë një auditi, kompania duhet t'i sigurojë AQSCERT prova objektive të një hetimi mbi faktorët që e shkaktojnë atë, risqet e ekspozuar dhe planin e propozuar të veprimeve korrigjuese. Kjo duhet të dorëzohet brenda 3 muajve pas auditit.
2) Veprimet korrigjuese duhet të implementohen nga kompania brenda 12 muajve pas auditit.
3) Implementimi i veprimeve korrigjuese dhe përcaktimi i efikasitetit duhet rishikuar në auditin tjetër të programuar.
4) Një jo-konformitet madhor lëshohet në rastin e mos plotësimit e plani të aprovuar në auditin tjetër on-site të programuar.

Një jo-konformitet madhor lëshohet kur gjetjet ndikojnë në aftësinë e sistemit të menaxhimit për të arritur rezultatet e synuara:
1) Kur një jo-konformitet madhor lëshohet gjatë auditit, kompania duhet t'i sigurojë AQSCERT prova objektive të një hetimi mbi faktorët që e shkaktojnë atë, risqet e ekspozuar dhe plani i propozuar për veprimet korrigjuese. Kjo duhet siguruar brenda 14 ditëve pas auditit.
2) Veprimet korrigjuese duhet të implementohen nga kompania brenda 14 ditëve nga auditi.
3) AQSCERT do mbyll jo-konformitetet madhore brenda 14 ditëve pas implementimit të veprimeve korrigjuese nga kompania. Kompania duhet t'i dorëzojë AQSCERT prova objektive të implementimit të masave korrigjuese.
4) AQSCERT do kryejë një audit tjetër që të verifikojë implementimin e veprimeve korrigjuese që të mbyllen jo-konformitetet madhore. Në rastet, kur provat dokumentare janë të mjaftueshme për mbylljen e jo-konformiteteve madhore, AQSCERT mund të vendosë të kryejë një rishikim në zyrë.
5) Përfundimi i veprimeve korrigjuese mund të kërkojë më shumë kohë në varësi të ashpërsisë së jo-konformitetit madhor dhe sasisë së punës që duhet për të eleminuar faktorët shkaktarë. Në raste të tilla, Veprimet korrigjuese duhet të përfshijnë masa ose kontrolle të përkohshme të nevojshme për të zbutur riskun derisa të implementohet veprimi korrigjues i përhershëm. Një audit i mëtejshëm do zhvillohet që të verifikohet veprimi korrigjues i përhershëm dhe mbylljen e jo-konformitetit madhor.
6) Një jo-konformitet kritik lëshohet në rast të mos zbatimit të veprimeve korrigjuese të aprovuara.

Një jo-konformitet kritik lëshohet kur gjatë auditit vihet re një impakt direkt mbi sigurinë ushqimore pa veprim korrigjues të ndërmarrë nga kompania ose kur ligjshmëria dhe/ose certifikimi janë në diskutim:
1) Kur një jo-konformitet kritik vëzhgohet në sitin e certifikuar, certifikata duhet pezulluar menjëherë për një periudhë maksimumi prej 3 muajsh.
2) Kur një jo-konformitet kritik lëshohet gjatë auditit, kompania duhet t'i sigurojë AQSCERT prova objektive të një hetimi mbi faktorët shkaktarë, risqeve të ekspozuar dhe plani të propozuar të veprimeve korrigjues. Kjo duhet siguruar 14 ditë pas auditit.
3) Një audit i mëtejshëm do zhvillohet nga AQSCERT brenda 3 muajsh që të verifikohet mbyllja e jo-konformitetit kritik. Nëse rezultati është pozitiv, auditët e mëtejshëm do zhvillohen sipas programit.
4) Në rastin e një auditi fillestar, auditi i plotë i certifikimit do përsëritet.

Gjithashtu, nëse nuk ka autorizime ose regjistrime të sitit, sic kërkohen nga legjislacioni aktual, procesi i certifikimit do pezullohet.

5.2. AUDITI I CERTIFIKIMIT FILLESTAR

Auditi i certifikimit fillestar përbëhet nga dy faza (Faza 1 dhe Faza 2)

5.2.1. Faza 1

Si zëvendësim i cfarë është përmenduar në paragrafin 5.2.1. të Rregullores së Përgjithshme, Faza 1 e Auditit që kryhet në kompani ka si qëllimi:

- Të verifikojë dokumentacionin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore, duke përfshirë procedurat, përmbushin tërë kërkesat e standartit;
- Të vlerësojë nëse auditët e brendshëm dhe rishikimi nga menaxhmenti i lartë janë planifikuar dhe zbatuar në tërë sitet e kompanisë që mbulohen nga certifikimi.
- Rishikimin e statusit dhe informimin e klientit në lidhje me kërkesat e standartit, me referencë të vecantë identifikimit të performancave kyc ose aspekte, procese, objektiva dhe operacione të rëndësishme për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore;
- Mbledhjen e informacionit të nevojshëm në lidhje me fushën e sistemit të menaxhimit, procese/vendndodhjen e klientit, duke përfshirë ligje dhe rregullore dhe zbatimi i tyre;
- Që kompania të ketë tërë autorizimet/licencat e nevojshme mbi Sigurinë Ushqimore dhe aktiviteteve të tij dhe që janë të vlefshme dhe në përputhje me ligjin në fuqi;

- Të hetojë sitet e Prodhimit/Kompaninë që të vlerësojë problemet e mundshme që nuk janë konsideruar nga Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të Kompanisë;
- Të rishikojë shpërndarjen e burimeve për fazën 2 të auditit dhe të pajtohet me detajet e klientit për fazën 2 të auditit;
- Të përqëndrohet në planifikimin e fazës 2, duke fituar informacion të mjaftueshëm mbi sistemin e menaxhimit, aktivitetet dhe sitin e klientit, me aspektet e mundshëm të rëndësishëm;
- Që SMSU (FSMS) ka qenë operacional për të paktën 3 muaj dhe që procedurat implementohen në mënyrë efikase.

Rezultati i fazës 1 të auditit është lënia në kompani e një kopieje të raportit të fazës 1 të auditit, ku ndër të tjera, janë raportuar gjetje që mund të jenë hasur, duke përfshirë edhe ato që klasifikohen si jo-konformitete (madhore ose minore) për fazën 2 të auditit.
Veprimet që merren nga Kompania për zgjidhjen e këtyre gjetjeve verifikohen gjatë fazës 2 të auditit në paragrafin 5.2.2
Në rast të jo-konformiteteve që janë kritike, grupi i auditit që kryen fazën 1 të auditit vendos nëse duhet të zgjidhen para kryerjes së Fazës 2 të auditit të kompanisë. Në rast të fazave 1 dhe 2 të njëpasnjëshme të auditit, Faza 2 duhet të ri-programohet dhe të shtyhet në një datë që nuk i kalon 3 muaj nga data e fazës së parë të auditit.

5.2.2. Faza 2
Si zëvendësim i cfarë është përmendur në paragrafin korrespondues 5.2.2 të Rregullores së përgjithshme, faza 2 e auditit tek kompania duhet kryer brenda një periudhe maksimumi prej 3 muajsh që nga përfundimi i fazës 1 të auditit.
Faza 2 e auditit në kompani kryhet për të verifikuar implementimin korrekt dhe efektiv të Sistemit të Menaxhimit.
AQSCERT i dërgon kompanisë, para fazës së dytët të audit në sit/e, një plan auditi (FO-C-007), në të cilin është dhënë me detaje, përshkrimi i aseteve dhe mjeteve për zhvillimin e auditit. Nëse aktivitetet do kontrollohen në disa site, auditi zhvillohet sipas kritereve të përcaktuar më përpara dhe të komunikuar nga AQSCERT.

Faza 2 e auditit kryhet nga një grup auditi i AQSCERT bazuar në raportin e fazës 1 të auditit dhe në dokumentet e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore të përgatitur nga kompania në një rishikim të përditësuar.

Faza 2 e auditit përbëhet nga:
- Një takim fillestar me Teknikët e Organizatës që të vendosen fusha dhe metodat e auditit dhe që të konfirmohet plani i auditit;
- Një rishikimi i implementimit të masave efektive të adaptimit në lidhje me vërejtjet e bëra gjatë fazës 1 të auditit;
- Një inspektim i sitit/eve të prodhimit/Kompanisë që të verifikohet pajtueshmëria me dokumentet referencë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore;
- Një mbledhje përfundimtare për të sqaruar rezultatet e vlerësimit.

Me perfundimin e auditit faza 2, kompanisë i dorëzohet një raport audit (FO-C-008). Në prani të moskonformiteteve të mëdha (gjetjet e tipit A), procesi i certifikimit pezullohet; në rastin e moskonformiteteve të vogla numri i të cilit, sipas mendimit të grupit të auditimit, është i tillë që të paragjykojë funksionimin korrekt të Sistemit të Menaxhimit, procesi i certifikimit pezullohet gjithashtu.
Në raste të tilla, brenda gjashtë muajve, AQSCERT duhet të kryejë një auditim shtesë që ka për qëllim verifikimin e efektivitetit të trajtimeve dhe të veprimeve korrigjuese të propozuara; pas përfundimit të suksesshëm të këtij auditimi, ndodh rifillimi i procesit të certifikimit.
Auditimi shtesë mund të kryhet në vend ose në baza dokumentare bazuar në llojin e veprimeve korrigjuese që duhet të verifikohen sipas mendimit të ekipit të auditimit.
Të gjitha shpenzimet në lidhje me çdo auditim shtesë që rezulton nga mangësitë në Sistemin e Menaxhimit janë në ngarkim të kompanisë kliente.
Nëse afati i lartpërmendur është tejkaluar, Sistemi i Menaxhimit të Organizatës duhet të jetë subjekt i një auditimi brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh nga data e përfundimit të fazës 2 të auditimit, duke përdorur kriteret (metodat dhe kohën e auditimit) të parashikuara për një auditim të fazës 2.
Nëse periudha e mësipërme dymbëdhjetë mujore kalon pa përfundim pozitiv të vlerësimit, AQSCERT mund të konsiderojë të mbyllur procedurën e certifikimit, duke ngarkuar kohën dhe shpenzimet e bëra deri në atë kohë.
Në raste të tilla kompania që dëshiron të vazhdojë me certifikimin duhet të paraqesë një kërkesë të re dhe të përsërisë procesin e certifikimit.
Kufijtë e lartpërmendur mund të ndryshohen në raste të veçanta me kërkesë të arsyetuar nga kompania, dhe të gjykuar nga AQSCERT.

6.2. AUDITËT E MIRËMBAJTJES

6.3.3 Auditët Pa Palajmërim (pika 3.3 në Rregulloren e Përgjithshme)

AQSCERT përcakton datën e auditit pa palajmërim. Siti nuk do lajmërohet paraprakisht, nga AQSCERT, mbi datën e auditit pa palajmërim. Kur ka arsye të vlefshme biznesi, periudha ndërprerjeje përcaktohen paraprakisht midis AQSCERT dhe kompanisë së

certifikuar që të shmangen periudha ekstreme pengese gjatë të cilave kompania do e ketë të vështirë të marrë pjesë plotësisht ose/dhe nuk ka prodhim. Një auditit pa palajmërim zhvillohet gjatë orëve operacionale përfshirë turneve të natës. Auditi pa palajmërim është një audit mirëmbajtjeje i plotë gjatë të cilit auditori do kalojë të paktën 50% të kohës në zonën e prodhimit duke vlerësuar implementimin e masave të kontrollit (CCP), masat paraparake (PRP, OPRP). Auditi do fillojë me një inspektim të zonave të prodhimit, duke filluar një orë pasi auditori ka mbërritur në sit. Në rast të shumë ndërtesave në sit, auditori do vendosë në bazë të risqeve se cilat ndërtesa do kontrollohen dhe sipas cilës radhë.

Auditori kontrollon veprimtarinë e kompanisë në një numër përfaqësues të linjave të prodhimit të mbuluara nga fusha e certifikimit.

Zyrat qëndrore që kontrollojnë disa funksione të rëndësishme në lidhje me certifikimin të ndara nga siti/et nuk auditohen gjatë auditit të palajmëruar por auditohen të lajmëruara.

Sitet dytësore (aktivitetet off-site) dhe magazinat off-site, depot dhe ndërtesat e shpërndarjes gjithashtu auditohen gjatë auditit pa palajmërim.

6.5 KALIMI (PËRDITËSIMI) NGA CERTIFIKIMI ISO 22000 NË FSSC 22000

Përvec cfarë është përmenduar në kapitullin 5 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit dhe në paragrafët e mësipërm, përcaktohen rregullat që do aplikohen kur kompania kërkon një kalim (azhornim) të certifikimit ekzistues ISO 22000 në FSSC 22000.

6.5.1. Azhornimi nga ISO 22000 në FSSC 22000

Kur bëhet kalimi i një certifikimi ISO 22000 në certifikim FSSC 22000, nuk nevojiten një audit i plotë me fazë 1 dhe fazë 2 për të azhornuar pjesën ISO 22000 të FSMS në FSSC 22000.

Auditi i certifikimit është një audit me fazë të vetme (Faza 1 dhe faza 2) zakonisht i kombinuar me një audit të planifikuar mirëmbajtjeje ISO 22000 ose një audit ri-certifikimi, por duhet zhvilluar si një audit specifik në një kohë pasuese të ndryshme.

Në rast se auditi certifikues FSSC 22000 është i kombinuar me një audit të programuar mirëmbajtjeje ISO 22000, me një audit të programuar ri-certifikimi ose zhvillohet si një audit specifik në një kohë tjetër, auditi duhet të përfshijë ISO 22000, specifikimet e aplikueshme teknike për masat paraprake të sektorit dhe kërkesat shtesë të FSSC 22000.

KAPITULLI 7 – MENAXHIMI I CERTIFIKATAVE TË KONFORMITETIT

Përvec cfarë përmendet në kapitullin 6 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, më poshtë përcaktohen rregullat që do aplikohen kur një kompani kërkon transferimin (azhornimin) e certifikimit ekzistues ISO 22000 në FSSC 22000.

7.4 LËSHIMI DHE VLEFSHMËRIA E CERTIFIKATËS

Në rast kalimi (azhornimi) nga certifikimi ISO 22000 në FSSC 22000, kompania e certifikuar zakonisht shkëputet nga certifikata ISO 22000. Në këtë rast certifikata e sapolëshuar o jetë vetëm certifikata FSSC 22000. Prandaj certifikata ISO 22000 do tërhiqet. Fusha e treguar në certifikata duhet të mbulojë tërë processet.

Nuk lejohet që të përjashtohen pjesë të procesit në fushë.

Data e lëshimit të certifikatës është data e lëshimit të certifikatës FSSC 22000. Auditit i azhornimit rezulton në një certifikatë FSSC 22000 me një vlefshmëri prej 3 vjetësh.

7.5 – PASOJA PËR CERTIFIKATËN EKZISTUESE ISO 22000

Nuk ndodh që të lëshohet një certifikatë ISO 22000 për të njëjtën fushë si certifikata FSSC 22000. Prandaj zakonisht certifikata ISO 22000 tërhiqet.

Në rast se kompania e certifikuar dëshiron të mbajë certifikatën ISO 22000 për të njëjtën fushë si FSSC 22000, atëherë proceset e lidhur do mbeten të vlefshëm dhe menaxhohen si duhet. Certifikata ISO 22000 do mbetet e vlefshme me datat origjinale të lëshimit dhe skadencës të pandryshuara. Një certifikatë ISO 22000 e vecantë për proceset që nuk mbulohen nga fusha e FSSC 22000 mund të lejohet me kusht që aktivitetet, proceset, produktet ose shërbimet të mbuluara nga fusha e certifikatës ISO 22000 nuk ndikojnë në sigurinë ushqimore të produktit përfundimtar të mbuluar nga fusha e certifikatës FSSC 22000.

KAPITULLI 8 – KOMPANITË ME SHUMË SITE

8.1 Si zëvendësim i paragrafit 8.1 të Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, kur një kompani vepron në shumë site dhe tërë funksionet të lidhura me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore menaxhohen nga një zyrë qëndrore dhe duhet një certifikim i vetëm, auditi mund të kryhet duke marrë mostra të siteve që do auditohen vetëm për kategoritë ISO / TS 22003:2013 dhe nëse numri i siteve i kalon 20, me kusht që :

- Aktiviteti që do certifikohet është i njëjtë për të tëra sitet dhe kompania aplikon të njëjtin Sistem Menaxhimi të Sigurisë Ushqimore (të kontrolluar nga një sit qëndror) për të gjitha sitet;

- Në të tërë sitet produktet/shërbimet e Kompanisë janë në thelb të të njëjtit lloj dhe bëhen me të njëjtat emtoda dhe procedura dhe tërë sitet ndodhen në të njëjtin shtet;
- Aktivitetet e mëposhtme menaxhohen nga zyrat qëndrore të Kompanisë:
  - Procedurat e Komunikimit;
  - Përgjigjet e Menaxhimit dhe të emergjencave;
  - Analiza e rreziqeve dhe identifikimi i rreziqeve shoqëruese;
  - Sistemi i gjurmueshmërisë
  - Vlerësimi i kërkesave për trajnime;
  - Kontrolli i dokumentave dhe ndryshimeve të tyre;
  - Rishikimi i sistemit të menaxhimit nga menaxhmenti i lartë;
  - Vlerësimi i efektivitetit të masave korrigjuese dhe parandaluese;
  - Planifikimi/zbatimi i auditëve të brendshëm dhe vlerësimi i rezultateve të tyre;
  - Para auditit nga AQSCERT, kompania duhet të ketë kryer audit të brendshëm në cdo sit.

8.2 Si zëvendësim i pikës 8.2 i Rregullores së Përgjithshme për Certifikimin e Sistemit të Menaxhimit, gjatë auditit për certifikim fillestar, mirëmbajtje, dhe ri-certifikim do merren mostra në përputhje me ISO/TS 22003:2013.